

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

GUSHT 2015

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Mos e hapni testin dhe mos filloni t'i zgjidhni detyrat pa ju dhënë leje mbikëqyrësi kujdestar.

Testi përmban detyra të cilave duhet t'u përgjigjeni në këtë mënyrë:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë;
- duke shkruar përgjigje të shkurtër ose më të gjatë;
- duke shkëputur pjesë (fjalë, grup fjalësh, fjali ose paragrafë nga tekstet e dhëna);
- duke shkruar tekst në vendin që është paraparë për të;
- duke shkruar ese.

Gjatë dhënies së përgjigjeve duhet të keni kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe zbatimin e normave drejtshkrimore. **Shkruani lexueshëm.** Përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë nëse janë të palexueshme, janë shkruar me shkronja të mëdha shtypi pa e veçuar shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë, nëse ka paedukatë në të shprehur, nëse në mënyrë të drejtpërdrejtë i drejtoheni vlerësuesit, nëse keni shkarravitur ose keni rrethuar më shumë alternativave.

Si në test, ashtu edhe në fletën e përgjigjeve, shkruani me laps kimik ose stilolaps. Përgjigjet dhe detyrat e shkruara me laps të thjeshtë, vlerësohen me zero (0) pikë. **Pranë çdo pyetjeje dhe detyre janë dhënë pikët për përgjigjen e saktë.**

Së pari duhet të zgjidhni detyrat në test dhe pastaj hartoni punimin me shkrim. Kur ta përfundoni testin, kontrolloni edhe njëherë përgjigjet tuaja. Pasi t'u përgjigjeni pyetjeve në test, përgjigjet e detyrave me zgjedhje të shumëfishtë bartni në fletën e përgjigjeve e cila ndodhet në këtë test. Fletën pastaj kthejeni në test.

Ju dëshirojmë sukses!



FAQE E ZBRAZËT

Duke shfrytëzuar tekstin e dhënë përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kulla e Ajfelit, simboli i Parisit dhe shembulli i thjeshtësisë së rafinuar, në figurën e vet elegante fsheh një mekanizëm të përbërë. Pompat e bashkuara në mënyrë speciale, ngrohësit dhe ndriçimi e mbajnë shkëlqimin e jashtëm të damës së çeliktë 119 vjet të vjetër, kurse dhëmbëzoret e mëdha, rrotat dhe kabllot kërcasin thellë në brendinë e saj, në vendet që asnjë turist nuk i sheh. Përkujdesja për përmbajtjen e fshehur të kësaj përmendoreje është e mundimshme dhe shpesh herë një punë e rrezikshme që e mban kullën në shfaqjen e saj më të mirë të kartolinave, thuhet në shkrimin që këto ditë e botoi Agjencia DPA. Më shumë se 500 njerëz, prej farkëtarëve dhe hidraulikëve deri te rojtarët dhe kuzhinierët, punojnë në strukturën e hekurt.

Në bodrumet e gjerë ndër këmbët e kullës gjenden motorët hidraulikë që i vënë në lëvizje dy ashensorët e vizitorëve. Zbritja nëpër shkallët spirale, pranë rrotave shumë të mëdha që ngadalë i mbështjellin kabllot e trashë të çeliktë, i ngjan shkuarjes në piknik të kohës së revolucionit industrial. Rezervuari me 4.000 litra ujë, që dikur është nxjerrë me pompë nga Sena, ia jep kullës baraspeshën e nevojshme që 18.000 vizitorët e përditshëm të ngjiten në nivelin e dytë të lartë 115 metra. Pjesët e panumërta të motorëve, të cilat vazhdimisht trokasin, kërkojnë lyerje të shpeshtë dhe kontroll të përditshëm. Madje edhe defekti i shkurtër i njërit prej ashensorëve mund t'i dyfishojë radhët e vizitorëve.

Ashensorët për vizitorë të kryeveprës së Gustav Ajfelit janë vendosur në vitin 1899, 10 vjet pas hapjes së saj. Bashkë me ashensorët bashkëkohorë që shkojnë deri te platforma në lartësi prej 276 metrave, ngritësit kalojnë nga 97.775 kilometra në vit.

Numri i shkallëve deri në majë të kullës ndër vite ka qenë i ndryshëm, nëpër restaurime të llojllojshme: në kohën e ndërtimit ka pasur 1710 shkallë deri në majë në 300, 65 m; pas restaurimit gjatë viteve të tetëdhjeta kishte 1920 shkallë; ndërsa sot ka 1665 shkallë. Publiku nuk ka qasje në majën e saj me shkallë – deri në majë arrihet me ashensor nga platforma tjetër.

Edhe pse është dashur të hiqet pas 20 vitesh, kulla mbeti për shkak të rolit të rëndësishëm të transmetuesit telegrafik. Sot, megjithatë, më së shumti të holla sjellin turistët. Prodhuesi francez i automobilave Citroen e shfrytëzoi kullën për reklamën e vet të madhe që përbëhej prej 250.000 llambave ndriçuese, që në Gini është shënuar si reklama më e madhe në botë. Ajo e zbukuronte kullën që nga viti 1925 deri në vitin 1934.

Në strukturën e kësaj përmendore janë instaluar me dhjetëra kilometra gypa hidraulikë, kurse ngrohësit e vegjël e mbrojnë atë nga ngrirja, prandaj ujë ka edhe kur dimrat janë shumë të ashpër. Ekipi prej 30 bojaxhinjve punon me orar të plotë më shumë se 18 muaj për ta lyer kullën me shtresë të freskët të ngjyrës së saj të njohur të bronzit. Madje edhe ndërrimi i dritave në Kullën e Ajfelit është një ndërmarrje e vërtetë. Për ndërrimin e një prej 360 burimeve të dritës nevojitet një ekip i alpinistëve me pajisje të plotë të sigurisë.

- Nëse ju bie diçka, qoftë ajo edhe një kaçavidë e vogël, kjo mund të jetë vdekjeprurëse për dikë - thotë elektrikisti Anri Pelie, i cili në Kullën e Ajfelit punon 14 vjet. Për fat të mirë, siç thonë elektrikistët, 20.000 dritat në miniaturë në sajë të të cilave kulla begatshëm lahet në dritë gjatë gjithë natës, kanë garanci me kohëzgjatje

prej 10 vjetësh. E ngritur si një simbol i Ekspozitës Botërore në vitin 1899, Kulla e Ajfelit paraqet një revolucion në arkitekturë. Jo vetëm që ka qenë ndërtimi më i lartë në botë, por ka shënuar edhe ndërprerjen radikale me godinat e ulëta prej gurit në Paris.

(Teksti është përgatitur nga burimet e ndryshme)

1. Kulla e Ajfelit për arkitekturën e botës është një:

1. ndërmarrje e vërtetë
2. objekt i tipit modern
3. përmendore e rrallë
4. revolucion i vërtetë

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

2. A) Sqaro përse vizita në Kullën e Ajfelit përkujton në një piknik në kohën e Revolucionit Industrial.

B) Në çfarë mënyre arrijnë vizitorët deri në majë të Kullës së Ajfelit?

2 pikë

3. Në cilin vit është hapur Kulla e Ajfelit?

1 pikë

4. Kulla e Ajfelit nuk është hequr pas 20 vjetësh sepse:

1. ishte objekti më i madh në botë
2. kishte rolin e rëndësishëm të transmetuesit
3. shërbente për reklamën më të madhe në botë
4. tërhiqte një numër të madh të turistëve

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

5. Sa është lartësia e Kullës së Ajfelit?

1 pikë

6. Sqaro cila punë është veçanërisht e rrezikshme në mirëmbajtjen e Kullës së Ajfelit.

1 pikë

Lexoje tekstin dhe përgjigju në pyetjet 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Qytetërimi egjiptian filloi të ngrihej rreth vitit 3150 p.e.r. sipas kronologjisë konvencionale egjiptiane kur u krye bashkimi politik i Egjiptit të Sipërm e të Poshtëm nën faraonin e parë. Historia e Egjiptit të lashtë ndodhi në një seri Mbretërisht të qëndrueshme, të ndara nga periudha paqëndrueshmërie të njohura si Periudhat e Mesme.

Mbretëria e Vjetër i përket Epokës së Hershme të Bronzit, Mbretëria e Mesme dhe Mbretëria e Re Epokës së Vonë të Bronzit. Egjipti e arrinë kulmin e fuqisë së tij gjatë Mbretërisë së Re, në periudhën e Ramsesit, pas së cilës filloi të binte

ngadalësisht. Egjipti u pushtua radhë pas radhe nga fuqi të huaja gjatë kësaj periudhe të vonë.

Pas vdekjes së Aleksandrit të Madh, një nga gjeneralët e tij, Ptoleme Soteri, shpalli veten si sundues të ri të Egjiptit. Kjo Dinasti Ptolemaike sundoi Egjiptin deri në vitin 30 p.e.r., kur u pushtua nga Perandoria Romake dhe u bë një provincë romake. Gërmadhat monumentale të tij kanë frymëzuar imagjinatën e udhëtarëve dhe shkrimtarëve për shekuj me radhë. Interesi dhe respekti i rikthyer këto dy shekuj të fundit për gërmadhat dhe gjërat antike çoi në krijimin e hetimit shkencor të qytetërimit egjiptian dhe në një vlerësim më të lartë për trashëgiminë e tij kulturore, si për Egjiptin ashtu edhe për botën.

Në shekullin e 3-të p.e.r. prifti Manetho e grupoi listën e gjatë të faraonëve nga Menesi në kohën e tij në 30 dinasti, një sistem i përdorur edhe sot . Ai vendosi ta fillojë historinë zyrtare të tij me një mbret të quajtur "Meni" (ose Menes në greqisht) i cili mendohet të ketë bashkuar dy mbretëritë e Egjiptit të Sipërm dhe Egjiptit të Ulët (rreth vitit 3100 p.e.r.). Tranzicioni në një shtet të bashkuar mund të ketë ndodhur më gradualisht se ç'thonë shkrimtarët e lashtë egjiptianë dhe nuk ka asnjë provë bashkëkohore të Menesit.

Disa studiuesë tani besojnë, megjithatë, se Menesi mitik mund të ketë qenë faraoni Narmer, që paraqitet veshur me rroba dhe shenja mbretërore në Paletën Narmer si simbol i aktit të bashkimit.

Në Periudhën e Hershme Dinastike rreth vitit 3150 p.e.r., të parët nga faraonët dinastikë forcuan sundimin tyre mbi Egjiptin e Ulët duke vendosur për kryeqytet Memfisën nga i cili mund të kontrollonin forcën punëtore dhe bujqësinë e rajonit pjellor të deltës ashtu si dhe rrugët tregtare të rëndësishme e fitimprurëse për në Levant.

Përparime të mahnitshme në teknologji u bënë gjatë Mbretërisë së Vjetër, të nxitura nga prodhimtaria bujqësore në rritje e bërë e mundur nga një administratë qendrore e organizuar mirë. Nën drejtimin e vezirit, zyrtarët e shtetit mbledhnin taksat, kordinonin projektet vaditëse për të përmirësuar prodhimin e të korrave, zgjidhnin fshatarët për të punuar në projekte ndërtimi dhe vunë në funksionim një sistem drejtësie për të mbajtur në vend paqen dhe rendin.

(Teksti është përgatitur nga burimet e ndryshme)

7. Ideja themelore e këtij teksti është:

1. të dëshmojë ngritjet e Egjiptit gjatë viteve 30 të mijëvjeçarit të fundit
2. të paraqes faktet e rëndësishme nga themelimi i qytetërimit egjiptian
3. të tregojë për faktet e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Egjiptit
4. të tregojë lidhjet kulturore dhe historike të Egjiptit me fqinjët e tij

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

8. Egjipti e arrin kulmin e fuqisë së tij gjatë:

1. Mbretërisë së Re, gjegjësisht në kohën e Ramsesit
2. Shekullit të 3-të p.e.r., në kohën e priftit Manetho
3. Mbretërisë së Vjetër, Epokës së Hershme të Bronzit
4. Periudhës së Hershme Dinastike rreth vitit 3150 p.e.r.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

9. Si grupohen faraonët nga Menesi?

1 pikë

10. Duke u bazuar në tekstin e dhënë si paraqitet Menesi mitik i vërejtur nga disa studiues?

1 pikë

11. Cilat ishin arsyet kryesore që faraonët e përcaktuan Memfisin si kryeqytet i Egjiptit të Ulët?

1 pikë

Duke shfrytëzuar tekstin e dhënë zgjidhi detyrat 12, 13 dhe 14.

Si thua ti? Shkollë ka vetëm dy klasë gjimnaz, po ç'i sheh syri ia bën dora. Është tre-katër vjeçe më e vogël se ti. Sa për karakter e sjellje, veten ka shoqe. Me pak vullnet **mund të arrihet** gjithçka e bukur dhe e mirë.

(Letërsi artistike)

12. A) Sqaroje domethënien e frazeologjisë **ç'i sheh syri ia bën dora**.

B) Shkruaje edhe një frazeologjizëm me domethënie të ngjashme.

2 pikë

13. Fjalët e nënvizuar nga teksti i mësipërm sipas funksionit sintaksor janë:

1 pikë

14. A) Cili do të ishte sinonimi i fjalës karakter në kontekstin e fjalisë nga teksti i mësipërm?

B) Cakto antonimin e fjalës gjithçka.

2 pikë

15. Cili nga autorët ka kultivuar stilin himnizues heroik?

1. Ernest Koliqi
2. Gjergj Fishta
3. Lasgush Poradeci
4. Ndre Mjeda

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

Lexoje fragmentin në vazhdim dhe përgjigju pyetjeve 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 22.

PAS VDEKJES

Adham-Uti (i rëndë): Sido që duket ky emër, (këqyr Vurkon) un' e kam nderuar!

Zeneli (vështron Vurkun): Vërtet, vërtet! Zotëria është shëronjës i ndëgjuar.

Adham-Uti: Dhe shkronjëtor, vjerëshëtor!

Vurkua (duke unjur): T'u ngjatë jeta, doktor Adham - Uti! Besa gëzonem që njojtja sot zotërinë tënde! Nder i math, për zonë! Unë jam Vurkua, korrespondenti i gazetës "Rrufeja".

Adham-Uti: A! Qënkeni gazetar!

Vurkua: Ndaj të lutem të më thuash ç'mendonën njerzt' e mëdhenj për Shqipërinë, që të shkruajmë në gazetën tonë.

Adham-Uti: Domëthënë, ti kërkon sot nga unë "intervieë"?

Vurkua: Po, Zotëni, që ta botoj te " Rrufeja".

Adham-Uti: Mos thuaj "Rrufeja" po thuaj "Rrufe"! Rrufe, rrufeja; liri, liria dhe jo lirija! Do t' i them dhe Skendo beut! Kjo gjuhë që përdorni ju sot s'është shqip! Pun' e gjuhës ka rënë në duar të liga dhe kurrë s'ka për të vajtur mbarë!...Abetari që përdorni ju sot s'është për të qenë!...

Vurkua (i mpirë): Qysh! Po e ka vendosur Kongres' i Manastirit...

Adham-Uti (me rrëmbim): Kongres' i Manastirit? Ç'është ky Kongres' i Manastirit? Kush vate? A vajta unë?

Vurkua (duke qeshur): Pse s'vajte, or zot?

Adham-Uti: A! a! Përpara më thoshte: doktor efendi, tani qenkam vetëm zot , se fola të vërtetën! Tash'ato që janë! Dhe guxon të më kërkosh "intervieë"! Jo, jo, s'kam zakon unë, të jap "intervieë, jo për gazetatat tuaja.

Vurkua: S'pandeja kurrë..., s'të dija për armik të gazetave!

Adham-Uti: Ja ku e msove tani dhe thuaje në gjithë botën me anë të "Rrufesë", në ka njerz të këndojnë të tillë fletë!...Këto janë fjalët e fundit!

Vurkua: Janë mjaft pët t'u çuditur!

Adham-Uti: Posi, po! Skëndo beu e dha fjalën.

Vurkua: A e njeh zonjëzen Lulushe?

Adham-Uti: Po si s'e njoh! Tërvit kish t'ëmën me pak ethe. Për këtë lëngatë kam gjetur, si të thashë, një bar të çuditshëm: kush ësh' shëruar shëronet, në mos po vdes në gjumë pa kuptuar, pa u munduar aspak. Kështu, pra, kur e piu e em' e Lulushes...

Vurkua dhe **Zeneli** (bashkë): U shërua!

Adham-Uti (te Vurkua): Këto janë, zotëni, veprat e mia! Lëvdata s'dua! Fjalët i merr era!...Punë, punë. Ç'del nga gazetatat? Kurrëgjë!...Prandaj mos u mundo kot, mos humb kohën: nukë kërren dot asnjë fjalë prej meje!

Vurkua: (duke qeshur pak): Mjaft janë këto që fole, zotëni. Tani, t'u ngjatë jeta! Lamtumirë!, doktor efendi!...(del jashtë me vrap)

Adham-Uti (me inat): Ah, i mallkuar! Më bëre të flas shumë! Pa dashur të dhashë "intervieë"! Po të mos më dalç përpara syve tjetër herë!

(Nga Andon Zako Çajupi)

16. Cilës gjini letrare i përket fragmenti i mësipërm?

1 pikë

17. Përse e kritikon Adham-Uti Vurkuan?

1 pikë

18. Vurkua në dialogun që zhvillon me Adham-Untin kërkon:

1. intervistë
2. miqësi
3. respekt

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

19. Në fjalinë: “Ja ku e msove tani dhe thuaje në gjithë botën me anë të “Rrufesë”, në ka njerz të këndojnë të tillë fletë!...”, folja e nënvizuar është në kohën e tashme të:

1. dëftores
2. dëshirores
3. lidhores.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

20. Në kontekstin morfologjik: “ti”, është:

1. trajtë e plotë
2. trajtë e shkurtër
3. trajtë e shquar

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

21. Ku qëndron komizmi tek zbulimi i madh mjekësor i doktor Adham-Uitit?

1 pikë

22.

Kongresi i Manastirit që përmendet në tekstin e mësipërm është mbajtur në vitin:

1. 1555
2. 1908
3. 1909
4. 1972

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

Lexoji vargjet dhe përgjigju në pyetjet 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28.

TRINA

Molla t'kputuna një deget,
dy qershia lidhë n' një rrfanë,
ku fillojnë kufijt' e Geget,
rrijnë dy çika me një nanë.

Kreskë e bre perzie me lisa
rriten rrotull me çetinë,
plepa t'but' e qiparisa
mbëlojnë e veshin at' ledinë.

S'ushton mali prej baktie,
s' fryn murrani me duhi;
paq i kthjelltë prej perendie,
paq prej njerit e qeti.

Gurra e lugut veç ushtonte
si lahutë me kangë kreshnike;
e ndër pemë bylbyli këndonte
valle dasmet e fisnike.

Ngreh, bylbyl, n'at' hije valle,
ushto, gurrë trimneshë, n'shkamnijë;
bulk i natës kungallë, qi talle

nëpër gamba e për lamie,

këndoni, këndoni. Veç prej stanit
t'ardhmen Trina mbramje n'shpi,
tue blegrue një kij mbas zanit
t'deles nanë keni mi ndi.
Veç prej plehit gjel-kokoti
me njat za që s'nd'rron kurr-herë,
ka me gjegjë se a tue ndërrue moti
se a tue çue një tjetër erë.

(Nga Ndre Mjeda)

23. Cilit lloj letrar i përket kjo vepër?

1 pikë

24. Çfarë nënkupton poeti me vargun: “dy qershia lidhën n’ një rrfanë,”?

1 pikë

25. Cila figurë stilistike është përdorur në vargjet në vazhdim?

Gurra e lugut veç ushtonte
si lahutë me kangë kreshnike;

1 pikë

26. Çfarë rime ka përdorur autori në këtë poezi?

1 pikë

27. Bashkëtingëllorja "d" nga fjala *lëndinë* është një bashkëtingëllore:

1 pikë

28. Folja në vargun: "këndoni, këndon. Veç prej stanit...", është në mënyrën:

1 pikë

29. Po qe se në fjalinë: "Ne themi se atëbotë kishim mirëqenie e rehati të mjaftueshme", përdoret kryefjala në numrin njëjës dhe kallzuesi i shprehur me folje në kohën e kryer të thjeshtë, fjalia bën:

1. Ne thoshim se atëbotë kishim mirëqenie dhe rehati të mjaftueshme
2. Ne thamë se atëbotë kishim mirëqenie dhe rehati të mjaftueshme
3. Unë them se atëbotë kishim mirëqenie dhe rehati të mjaftueshme
4. Unë thashë se atëbotë kishim mirëqenie dhe rehati të mjaftueshme

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

30. Në vazhdim ke dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250-300 fjalë. Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXO HET FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Kij kujdes që në aspektin gjuhësor fjalia të jetë e qartë, e kuptueshme dhe të mos ketë gabime gjuhësore.

1. GAVRILL DARA (I RIU) „KËNGA E SPRASME E BALËS“

Udhëzime për shkrimin e esesë.

Shkruaj për:

- Periudhën letrare që i përket Gavrill Dara (I Riu) - veprat e Darës dhe gjuha në të cilën shkruante.
- Teknikën me të cilën Dara shkruante.
- Llojin poetik që i përket “Kënga e sprasme e Balës”.
- Subjektin e poemës.
- Personazhin kryesor Nikun dhe detyrën e tij.
- Vështirësitë që kalojnë dy të rinjtë pasi që njihen njëri me tjetrin.
- Çfarë ndodhë me Nikun në betejën e Vajkalit?
- Porosinë që i lë Niku bijës së Lalës para vdekjes.
- Reagimin e Marës pas tragjedisë që sheh.
- Zbërthimin dhe domethënien e vargjeve: “se, si u deshën përmbi dhe, ashtu duhen dhe nën dhe.”

2. KËRKIMI I JETËS NË MËRGIM E DREJTË APO GABIM?

Udhëzime për shkrimin e esesë.

Shkruaj për:

- Qëndrimin tënd ndaj braktisjes së vendlindjes.
- Arsyet të cilat ndikojnë në braktisjen e vendlindjes? Argumento përgjigjen tënde.
- Fenomenin e shpërnguljes si një e drejtë apo hap i gabuar. Argumento përgjigjen tënde.
- Ndonjë shembull që e njeh ti që ka marrë rrugën e shpërnguljes nga vendlindja. Kush janë ata njerëz që e braktisin vendin e vet?
- Mundësinë e braktisjes së vendlindjes nga ana jote dhe përse do ta bëje këtë? Argumentoje qëndrimin tënd.
- Pasojat e këtij fenomeni.
- Mundësinë e parandalimit të kësaj dukurie shqetësuese.
- Masat që duhet të ndërmerren për ndryshimin e kësaj gjendjeje që popullsia të qëndrojë në vendin e vet.

25 pikë

